



KONTRATË – FURNIZIM, MONTIM dhe INSTALIM

KUOTIM I QMIMIT

REPUBLICA E KOSOVËS-REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA E MITROVICËS-OPŠTINA MITROVICA
02 - M. PROKURIMET
Nr i QJ/Bror: 13.370/02-0059158/22
Data/Datumi: 27.06.2022
Loketimi: Mitrovicë - Mitrovica

TITULLI I KONTRATËS

Përshkrimi i Kontratës: **Furnizimi dhe Montimi i kamerave në QKMF, QMF-të dhe AMF-të.**

Numri i Prokurimit	642-22-4399-1-3-6
Numri i Brendshëm i Prokurimit	642/22/035/136

AUTORITETI KONTRAKTUES: **KOMUNA E MITROVICËS JUGORE**

OPERATORI EKONOMIK: Cimi @ ELECTRONIC SH.P.K. Rr.Azem Bejta, Skenderaj.

DATA E NËNSHKRIMIT: **27/06/2022**

KONTRATË: Furnizimi dhe Montimi i kamerave në QKMF, QMF-të dhe AMF-të.

Nr i prokur: 642-22-4399-1-3-6 dhe Nr i brend: 642/22/035/136

PJESA B: KONTRATË –FURNIZIM,MONTIM dhe INSTALIM

KOMUNA- MITROVICË JUGORE, (në vazhdim "Autoriteti Kontraktues"), në njëren anë;
dhe

Cimi @ ELECTRONIC SH.P.K. Rr.Azem Bejta, Skenderaj.

ne vazhdim "Kontraktori"), me nr Biznesi **811014696** nr i tel: **+383 44 712 720** ne anën tjetër, janë pajtuar te lidhin një kontrate publike si vijon Furnizimi dhe Montimi i kamerave në QKMF,QMF-të dhe AMF-të.

si në vijim:

Neni 1 Lënda: Furnizimi dhe Montimi i kamerave në QKMF,QMF-të dhe AMF-të.

me numër identifikues.

Numri i Prokurimit	642-22-4399-1-3-6
Numri i Brendshëm i Prokurimit	642/22/035/136

1.1 Lënda e kontratës do të jetë [FURNIZIM,MONTIM dhe INSTALIM], nga kontraktori i furnizimeve si në vijim:

Lënda e kontratës do të jetë **Furnizimi dhe Montimi i kamerave në QKMF,QMF-të dhe AMF-të.**

Operatori fitues i kontrates është i obliguar te furnizoj paisjet [EKIOSQET] sipas specifikave në DT dhe Përshkrimin e qmimeve te cilat i ka kërkuar njësia kerkuese [Drejtoria e Administrates e Komunës së Mitrovicës JUGORE].

Furnizimi dhe Montimi i kamerave në QKMF,QMF-të dhe AMF-të.	3.747,68 EUR
--	---------------------

1.2 Kontrata hynë në fuqi **27/06/2022 dhe përfundon me 26/07/2022**

1.3 Afati kohor i performances nuk mund të jetë më shumë **se 3 ditë** nga data e marrjes së urdhëreses.

1.4 Vendi i [kryerjes se FURNIZIMIT dhe MONTIMIT është **QKMF-ja,QMF-të dhe AMF-të.**

1.5 Incotermi i aplikueshëm do të jetë DDP¹ (Detyra e Dërguar e Paguar).

¹ DDP – Detyra e Dërguar e Paguar- Incoterms 2010 Oda Ekonomike Ndërkombëtare

KONTRATË: Furnizimi dhe Montimi i kamerave në QKMF,QMF-të dhe AMF-të.

Nr i prokur: 642-22-4399-1-3-6 dhe Nr i brend: 642/22/035/136

Neni 2 Ligji i aplikueshëm

2.1 Ligji i zbatueshëm do të jetë sipas Nenit 40 të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092 Për çështjet që nuk mbulohen me dispozita të kontratës, zbatohen ligjet në fuqi në Kosovë. Juridiksioni do të jetë gjykata përkatëse në Prishtinë.

Neni 3 Çmimi

3.1 Çmimi total i kontratës do të jetë:

Çmimi Total i ofertes **me TVSH** dhe vlerën e parashikuar **3.747,68 €**. **[Tre mijë e shtatëqindë e katërdhjetë e shtatë euro e 68/100 €]**.

3.2 Çmimi i përmendur në Nenin 3.1 më sipër duhet të jetë e vetmja pagesë që Autoriteti Kontraktues i ka borxh Operatorit Ekonomik sipas kontratës. Ai duhet të jetë i prerë dhe të mos i nënshtrohet ndryshimeve gjatë ekzekutimit të kontratës (në përjashtim të çmimeve të atyre artikujve që i nënshtrohen ndryshimit të çmimit sipas berzës përkatëse, nëse aplikohet).

Neni 4 Pagesat

4.1 Pagesa do të bëhet në Euro.

Autoriteti Kontraktues do të paguaj sipas të furnizimeve të kryera ose shumën totale të pagesës pas [furnizimit, montimit dhe Instalimit] dhe pas pranimit [njësitë e kërkeses] dhe raportit të nënshkruar nga Menaxheri I Kontratës.

[Autoriteti Kontraktues do të paguaj secilën shumë të detyrimeve pas pranimit të secilës dërgesë]

4.2 Pagesat e detyrimeve sipas një fature të lëshuar nga Operatori Ekonomik duhet të paguhet brenda jo më shumë se 30 ditësh nga data në të cilën kërkesa e pranueshme për pagesë është regjistruar nga departamenti përkatës. Data e pagesës do të jetë data në të cilën debitohet llogaria e institucionit. Kërkesa për pagesë nuk do të jetë e pranueshme nëse nuk plotësohen një ose më shumë nga kërkesat thelbësore.

Neni 5 Marrëveshjet lidhur me tatimin dhe doganën

5.1 Operatori Ekonomik është përgjegjës për të gjitha detyrimet dhe taksat në përputhje me Ligjin e Republikës së Kosovës.

5.2 Të gjitha taksat dhe detyrat e tjera doganore konsiderohen se janë të përfshira në çmimin e kontratës.

Neni 6 Kualiteti

6.1 Kualiteti i *[Furnizimeve]* duhet në të gjitha aspektet të **plotësoj specifikimet teknike të parashtruara në Dosjen e Tenderit.**

Neni 7 Garancioni

7.1 Garancioni do të mbetet valid për 36 muaj ose 3 vite në bazë të deklaratës së Kontaktorit në oferten e prezentuar

Neni 8 Vonesat në ekzekutim

8.1 Nëse Operatori Ekonomik me përgjegjësinë e tij nuk arrin *[te kryej ndonjë ose të gjitha punët]* brenda limiteve kohore të specifikuara në kontratë, Autoriteti Kontraktues, pa njoftim zyrtar dhe pa paragjykim ndaj

KONTRATË: Furnizimi dhe Montimi i kamerave në QKMF,QMF-të dhe AMF-të.

Nr i prokur: 642-22-4399-1-3-6 dhe Nr i brend: 642/22/035/136

kompensimeve tjera të tij sipas kontratës, do të ketë të drejtë, për secilën ditë që kalon ndërmjet skadimit të periudhës së kontratës dhe datës aktuale të përfundimit, t'i marrë dëmet e likuiduara të barabarta me 0,25% në ditë të vlerës së [punëve] të pa dorëzuara deri në një maksimum prej 10 % të vlerës totale të kontratës.

Neni 9 Inspektimi dhe testimi

9.1 Autoriteti kontraktues do të ketë të drejtë që herë pas here të inspektojë, kontrollojë, masë dhe testojë komponentët, materialet, dhe mjeshtërinë, dhe të kontrollojë përparimin e përgatitjes, fabrikimit apo prodhimit të çfarëdo artikulli që përgatitet, fabrikohet ose prodhohet për t'u dorëzuar sipas kontratës, në mënyrë që të përcaktojë nëse komponentët, materialet dhe mjeshtëria kanë cilësinë dhe sasinë e kërkuar.

Neni 10 Nën-kontraktimi

10.1 Një nënkontratë do të jetë e vlefshme vetëm nëse është një marrëveshje me shkrim me të cilin Operatori Ekonomik i beson kryerjen e një pjese të kontratës së tij një pale të tretë. Operatori Ekonomik nuk duhet të nënkontrakttojë pa autorizim paraprak me shkrim nga Autoriteti Kontraktues. Autoriteti Kontraktues do të njoftojë Operatorin Ekonomik për vendimin e tij brenda 5 ditëve nga marrja e njoftimit, duke i paraqitur arsyet e veta nëse nuk lëshohet autorizimi.

Neni 11 Ndërprerja e Kontratës nga Autoriteti kontraktues

11.1 Autoriteti kontraktues mundet që, pasi t'i japë Operatorit Ekonomik shtatë ditë paralajmërim, ta ndërpresë kontratën në ndonjërin nga rastet në vijim: a) Kur operatori ekonomik nuk arrin t'i realizoj obligimet e veta sipas kontratës; b) Dështon në ekzekutimin e kontratës në afatin e caktuar; c). Refuzon urdhrat administrativ të autoritetit kontraktues; d) Ia jep dikujt kontratën apo nënkontratën pa autorizim nga autoriteti kontraktues; e). Falimenton; f). Është dënuar nga një gjykatë për një shkelje që ka të bëjë me sjellje profesionale, përmes një gjykimi që ka fuqinë e *res-judicata*; g) Operatori ekonomik i është nënshtruar një gjykimi që ka forcën e *res judicata* për mashtrim, korrupsion, përfshirje në ndonjë organizatë kriminale ose ndonjë aktivitet tjetër ilegal që i dëmton interesat e përgjithshme financiare; h) shfaqet ndonjë paaftësi tjetër ligjore që i pengon realizimit të kontratës.

Neni 12 Ndërprerja e Kontratës nga Operatori Ekonomik

12.1 Operatori Ekonomik, pasi e ka paralajmëruar Autoritetin Kontraktues 14 ditë paraprakisht, mund ta ndërpresë kontratën nëse Autoriteti kontraktues: a) Nuk arrin t'i paguajë Operatorin Ekonomik shumën që duhet të paguhet brenda periudhës së saktësuar me kontratë; b) vazhdimisht nuk arrin t'i plotësojë obligimet e veta me kontratë; c) si rezultat i forcës madhore, Operatori Ekonomik nuk është në gjendje për të kryer një pjesë materiale të kontratës për më shumë se 180 ditë, për arsye që nuk janë specifikuar në kontratë ose që nuk i atribuohen të Operatorit Ekonomik.

Neni 13 Zgjidhja e mosmarrëveshjeve me procedurë gjyqësore

13.1 Nëse nuk mund të arrihet zgjidhje brenda 30 ditësh nga fillimi i procedurës miqësore për zgjidhje të mosmarrëveshjes, secila palë mund të kërkojë ose vendim nga gjyqi, ose vendim arbitrimi.

13.2 Çdo mosmarrëveshje ndërmjet palëve të cilat mund të lindin gjatë ekzekutimit të kësaj kontrate dhe se nuk është e mundur të zgjidhet ndryshe ndërmjet palëve do të dorëzohet në [specifiko gjykatën kompetente] në pajtim me ligjin e Kosovës.

Neni 14 Komunikimi

14.1 Çdo komunikim me shkrim në lidhje me këtë Kontratë ndërmjet Autoritetit Kontraktues dhe Operatorit Ekonomik duhet jap Titullin e kontratës dhe numrin e identifikimit, dhe duhet të dërgohet me postë, faks, e-mail ose me dorë.

E hartuar në gjuhën [Shqip] [Serbisht] [Anglisht] ² në tri origjinale, dy origjinale për Autoritetin Kontraktues dhe një origjinal për Operatorin Ekonomik.

Për Autoritetin Kontraktues: Komuna-Mitrovicë e JUGUT	
Emri:	Haxhimet FERATI
Pozita:	Zyrtar Përgjegjës i Prokurimit
Nënshkrimi:	
Data:	27/06/2022
Vula:	

Për Kontraktorin: Cimi @ ELECTRONIC SH.P.K. Rr.Azem Bejta, Skenderaj.	
Emri:	MISIM VOJVODA
Pozita:	Drejtör
NUI	811014696
Emajl adresa	<u>cimielectronicshpk@gmail.com</u>
Nr i tel	+383 44 712 720
Nënshkrimi:	
Data:	27/06/2022
Vula:	

² Gjuha do të jetë gjuha e përdorur nga tenderuesi në tenderin e tij.

KONTRATË: Furnizimi dhe Montimi i kamerave në QKMF,QMF-të dhe AMF-të.

Nr i prokur: 642-22-4399-1-3-6 dhe Nr i brend: 642/22/035/136

KUSHTET E VEÇANTA

NUMRI I TENDERIT : 642-22-4399-1-3-6

KVK NË VIJIM DO TË PLOTËSOJNË DHE/OSE NDRYSHOJNË KPK. SA HERË QË KA NJË
KONFLIKT, DISPOZITAT KËTU DO TË MBIZOTËROJNË MBI ATO TË KPK.

KPK		Amandamentimet / Modifikimi i Nenit përkatës në KPK
Përshkrimi i nenit	Neni	
Ligji i zbatueshëm dhe gjuha	1.1	Ligjet e Kosovës që janë në fuqi do të zbatohen për të gjitha çështjet që nuk mbulohen nga dispozitat e kontratës. Juridiksioni do të jetë gjykata përkatëse në Prishtinë.
	1.2	Gjuha e përdorur do të jetë SHQIPE .
Fillimi dhe Përfundimi i shërbimeve	1.3	Data e Fillimit të fillimit të Shërbimeve është: 30/06/2022
	1.4	Data e Përfundimit është: 26/07/2022
	1.5	Vendi i kryerjes së furnizimeve është QKMF-ja, QMF-të dhe AMF-të.
Emrimi i Menaxherit te Kontratës	1.6	Menaxheri i Kontratës është: [.....@rks-gov.net].
Dëmet e likuiduara	1.7	Dëmet e likuiduara për të gjitha furnizimet janë 0.25% e Çmimit përfundimtar të Kontratës për ditë. Shuma maksimale e dëmeve të likuiduara për të gjitha Punët është 10% e Çmimit final të Kontratës
Siguria e ekzekutimit	1.8	Shume e Sigurisë së Ekzekutimit është: N/A
Sigurimi që do të merret nga ofruesi i shërbimeve	1.9	Rreziqet dhe mbulimi nga sigurimi do të jenë: a) Përgjegjësia e Palës së Tretë [N/A] b) Përgjegjësia ndaj punëdhënësit dhe kompensimi i punëtorëve <i>[me marrëveshje te dy palëve]</i>

KONTRATË: Furnizimi dhe Montimi i kamerave në QKMF,QMF-të dhe AMF-të.

Nr i prokur: 642-22-4399-1-3-6 dhe Nr i brend: 642/22/035/136

		<p>c) Përgjegjësia profesionale [N/A]</p> <p>d) Humbja ose dëmtimi i pajisjeve dhe pronës [N/A]</p>
Parimet e përgjithshme të pagesës	1.10	<p>Orari i pagesës do të jetë: Autoriteti Kontraktues do të paguaj sipas situacioneve të furnizimeve të kryera pas [furnizimit, montimit dhe Instalimit] dhe pas pranimit [njësitë e kërkeses] dhe pas pranimit nga njësitë e kërkeses verifikimi i performancës së Pajisjeve dhe raportit të nënshkruar nga Menaxheri I Kontratës</p>
Kontrolli i kualitetit dhe Obligimet e Kontraktorit.	1.11	<p>Kontraktuesi duhet të furnizoj PAISJET të cilat duhet të montohen testohen dhe të lëshohen në Funkcion dhe të trajnohen Zyrtarë për përdorim [IT].:</p> <p>Garancioni i PAISJEVE dhe komponentëve përbërëse duhet të jete 12 muaj. Brenda periudhës garantuese.</p> <p>Operatortri Ekonomik është i obliguar të Furnizoj, Montoj, Instaloj dhe të vendos në funksion dhe të trajnoj STAFIN për përdorim[IT]</p>
Zgjidhja miqësore e mosmarrëveshjes	1.12	<p>Komisioni për Ndërmjetësim në kuadër të Ministrisë së Drejtësisë</p>
Zgjidhja e mosmarrëveshjes me procedure gjyqësore	1.13	<p>a) Çdo mosmarrëveshje ndërmjet palëve të cilat mund të lindin gjatë ekzekutimit të kësaj kontrate dhe se nuk është e mundur të zgjidhet ndryshe ndërmjet palëve do të dorëzohet Gjykatën Themelore-Prishtinë në pajtim me ligjin në Kosovë ose</p> <p>b) kurdo që palët pajtohen, çdo mosmarrëveshje ndërmjet palëve të cilat mund të lindin gjatë ekzekutimit të kësaj kontrate dhe se nuk është e mundur të zgjidhet ndryshe ndërmjet palëve do të dorëzohet në arbitrazh të Tribunali i Përhershëm i Arbitrazhit të Kosovës në kuadër të Odës Ekonomike të Kosovës, në përputhje me rregullat e Dhomës Ndërkombëtare të Tregtisë.</p> <p>Para nënshkrimit të kontratës palët duhet të vendosin për mënyrën e zgjidhjes së mosmarrëveshjes, gjykata apo arbitrimi.</p>

KONTRATË: Furnizimi dhe Montimi i kamerave në QKMF,QMF-të dhe AMF-të.

Nr i prokur: 642-22-4399-1-3-6 dhe Nr i brend: 642/22/035/136

PJESA V E KONTRATËS: IDENTIFIKIMI FINANCIAR

MBAJTËSI I LLOGARISË	
Emri	
Adresa	
Qyteti	
Kodi Postar	
Kontakti	
Telefoni	
Fax	
Ë-mail	
Numri i TVSH	

BANKA	
Emri	
Adresa	
Qyteti	
Kodi Postar	
Shteti	
Llogaria Bankare	
IBAN (opcionale)	
BIC (Opcionale)	

SHËNIME:

<u>VULA E BANKËS + NËNSHKRIMI I PËRFAQËSUESIT TË BANKËS (Të dyja të obligueshme).</u>

<u>DATA + NËNSHKRIMI I MBAJTËSIT TË LLOGARISË: (e obligueshme).</u>

KONTRATË: Furnizimi dhe Montimi i kamerave në QKMF,QMF-të dhe AMF-të.

Nr i prokur: 642-22-4399-1-3-6 dhe Nr i brend: 642/22/035/136

NENI II SPECIFIKIMI I QMIMEVE

Numri i Prokurimit: 642-22-4399-1-3-6 Numri i Brendshëm: 642/22/035/136- Titulli Furnizimi dhe Montimi i kamerave në QKMF,QMF-të dhe AMF-të.

Nr 1	Përshkrimi Furnizimi dhe Montimi i kamerave në QKMF,QMF-të dhe AMF-të.	Njësia matëse	Sasia	Cmimi njesi pa TVSH	TVSH	Çmimi njesi me TVSH	Gjithsejt TOTALI
1	IP Kamera statike (CCTV): Network Bullet Camera, 1/2.7" Progressive Scan CMOS, 2560 x 1920 @15fps, Color: 0.01 Lux @(F1.2; AGC ON), 0.028 Lux @(F2.0; AGC ON), 2.8 mm fixed lens, H.265+, H.265, H.264+, H.264, 3D DNR, IP67, working temperature -30 °C to +60 °C	Copë	4	90	€ 16.20	€ 106.20	€ 424.80
2	IP Kamera statike te brendshme (CCTV): Network turret camera, 1/3" progressive scan CMOS, 3D DNR, Up to 30 m IR range, Wavelength 850 nm, 2560 x 1440@20fps, 2.8 mm fixed lens, PoE (Power over Ethernet), H.265+, H.265, H.264+, H.264, IP 67, Dual stream, Digital WDR (Wide Dynamic Range), working temperature -30 °C to 50 °C	copë	18	65	€ 11.70	€ 76.70	€ 1,380.60
3	Surveillance sata disk; SATA 6 Gb/s, 5400 RPM Class, 3.5-inch, cache 64mb, working temperature 0 to 65	copë	2	45	€ 8.10	€ 53.10	€ 106.20
4	Switch 8 port POE; 8 PoE 10/100Base-TX Ethernet ports, 802.3af, 802.3at, working temperature (0 to 40C)	copë	2	75	€ 13.50	€ 88.50	€ 177.00
5	Switch 16 port POE; 16 PoE 10/100Base-TX Ethernet ports, 802.3af, 802.3at, working temperature (0 to 40C)	copë	1	135	€ 24.30	€ 159.30	€ 159.30
6	Kuti OG 85x85x45, e bardhe, IP55	copë	22	2	€ 0.36	€ 2.36	€ 51.92
7	NVR me aplikacion te integruar për IP kamera; 32 kanale deri ne 8 megapixel, 1 x Gigabit Ethernet NIC, 4K UHD output , 4 x SATA interfaces, 256 mbps incoming bandwidth, 160mbps outgoing bandwidth, working temperature -10 °C to 55 °C	copë	1	300	€ 54.00	€ 354.00	€ 354.00
8	Demontimi i kamerave ekzistuese	Copë	22	5	€ 0.90	€ 5.90	€ 129.80
9	Montimi dhe konfigurimi i kamerave te reja	Copë	22	25	€ 4.50	€ 29.50	€ 649.00
10	Konektor RJ-45 cat.6	Copë	50	0.1	€ 0.02	€ 0.12	€ 5.90

11	UTP kabell cat.6	Metër	200	1	€	0.18	€	1.18	€	236.00
12	Patch kabell cat.6 1m	Copë	22	1	€	0.18	€	1.18	€	25.9€
13	Kanale te plastikes per kabell 40x40x25	Metër	40	1	€	0.18	€	1.18	€	47.20
GJITHSEJTË TOTALI ME TVSH:										
									€	3,747.68

Identifikimi i operatorit ekonomik (oe)	
emri i OE:	cimi@electronic.shpk
emri dhe mbiemri i perfaqesuesit te O.E.	Misim Vojvoda
nenshkrimi:	
data dhe Vula:	13/05/2022

